



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
2021

Nr. Rendor	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	01.01.2021	Kërkesë për informacion me objekt listën me kërkuesit dhe objektin e të gjitha çështjeve, të cilat janë kualifikuar në dhomat e këshillimit, për t'u shqyrtuar në seancat plenare të Gjykatës Kushtetuese.	12.01.2021	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju lutem gjeni bashkëlidhur listën e çështjeve që janë në shqyrtim në seancë plenare. Në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale, individët janë paraqitur jo me emër të plotë por me initiale. Përgjigja e plote	E kufizuar	Nuk ka

2.	22.01.2021	Kërkesë për informacioni me objekt listën e padive të depozituara në Gjykatën Kushtetuese që kërkojnë vendimmarrje nga mbledhja e gjyqtarëve në zbatim të nenit 31, pika 3, paragrafi 2/“Në të gjitha rastet, kur ndonjë nga gjyqtarët e kolegjit nuk është i një mendimi me të tjerët, kërkesa i kalon për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve”; axhendën e Gjykatës për shqyrtimin e këtyre çështjeve nga Mbledhja e Gjyqtarëve.	28.01.2021	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju lutem gjeni bashkëlidhur listën e çështjeve për shqyrtim paraprak nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Pergjigja e plote	E kufizuar	Nuk ka
3.	02.03.2021	Kërkesë për informacion për vënien në dispozicion të kopjeve të vendimeve të marra në mbledhjen e gjyqtarëve datë 18.02.2021 si dhe kopje të shkresës P-3,	05.03.2021	Duke ju bërë me dije se në bazë të nenit 8, pika 5 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës Kushtetuese, i cili parashikon se “akte të tilla si: votimi i gjyqtarëve, projektvendime, shënime të	E kufizuar	Nuk ka

		Regj. Themeltar, datë 19.02.2021.		<p>relatorit dhe mendime të këshilltarit nuk janë pjesë e materialeve me të cilat mund të njihen pjesëmarrësit në gjykim”, kopjet e materialeve që keni kërkuar nuk mund t’ju vihen në dispozicion, ju lutem gjeni më poshtë informacionin që mund të jepet nga Gjykata në vijim të kërkesës suaj.</p> <p>Në shqyrtimin paraprak të kërkesës së paraqitur nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me nr. P- 2 Regjistri Themeltar, datë 14.05.2020 me objekt: <i>“Shfuqizimi i vendimit nr.377, datë 08.05.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë”, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Pezullimi i</i></p>		
--	--	-----------------------------------	--	--	--	--

			<p>zbatimit të vendimit nr.377, datë 08.05.2020 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin "Teatri Kombëtar", në zonën kadastrale 8150, Tiranë" dhe qëllimit të përcaktuar në këtë akt, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese mbi këtë çështje dhe mbi çështjen tjetër në shqyrtim, që lidhet me kundërshtimin e ligjit nr.37/2018 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar"", të hyjë në fuqi",</p> <p>Mbledhja e Gjyqtarëve e Gjykatës Kushtetuese në datën 18.02.2021 ka vendosur, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.99/2016 (nr. 8577/2000), gjykimin e çështjes në seancë plenare publike;</p> <p>Mbledhja e Gjyqtarëve, në datën 18.02.2021, ka marrë në shqyrtim kërkesën edhe për pezullimin e zbatimit të VKM-së dhe ka vendosur shqyrtimin e saj në seancë plenare.</p> <p>Gjithashtu, po në datën 18.02.2021 Mbledhja e Gjyqtarëve e Gjykatës Kushtetuese, bazuar në pikën 2 të nenit 1 të ligjit nr. 8577/2000, si dhe në nenin 158/a, pika 2, shkronja “ë”, të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur bashkimin e çështjeve që ju përkasin kërkesës me numër regjistri themeltar P-2, datë 14.05.2020 me kërkesën me</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>nr. P-3, datë 24.07.2019 me kërkues Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me objekt: <i>“Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe me Marrëveshjet Ndërkombëtare, të ligjit nr.37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar. Pezullimin e zbatimit të ligjit nr.37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”, në një çështje të vetme.</i></p> <p>Për zhvillimin sa më korrekt të këtij gjykimi, Gjykata Kushtetuese ju ka kërkuar të gjithë subjekteve në gjykim sjelljen e parashtrimeve me</p>		
--	--	--	--	--	--

				shkrim, nëse kanë argumente për kërkesat e paraqitura.		
4.	30.06.2021	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me takimin e Ambasadorit Soreca në Gjykatën Kushtetuese ku kërkohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Nëse ka qenë i planifikuar ky takim . 2.Përse ky takim u zhvillua në datën e seancës së Teatrit. 3.Kush ka qenë objekti i bisedimeve. 4.Pse nuk u bë publik takimi dhe objekti i bisedimeve 	30.06.2021	Përgjigja e plotë	E plotë	

5.	16.07.2021	<p>Kërkesë për informacion për vënien në dispozicion të dosjes së plotë dhe gjithë dokumentacionin shoqërues të paraqitur nga subjektet e interesuara për vendimin Nr. 29 , datë 02/07/2021 me Objekt: <i>Shfuqizimi i ligjit nr. 37/2018 Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Shfuqizimi i vendimit nr. 377, datë 08.05.2020 të Këshillit të Ministrave Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr. 1/241, me emërtimin Teatri Kombëtar në zonën kadastrale 8150, Tiranë, si i papajtueshëm me</i></p>	23.07.2021	<p>Në vijim të kërkesës suaj për informacion të datës 16/07/2021, drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet së cilës kërkohet dosja e plotë dhe gjithë dokumentacioni shoqërues i paraqitur nga subjektet e interesuara për vendimin Nr. 29, datë 02/07/2021 me Objekt: <i>Shfuqizimi i ligjit nr. 37/2018 Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Shfuqizimi i vendimit nr. 377, datë 08.05.2020 të Këshillit të Ministrave Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të</i></p>	E Plotë	Nuk Ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

		<p><i>Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Shfuqizimi i vendimit nr. 50, datë 14.05.2020 të Këshillit Bashkiak Tiranë, Bashkia e Tiranës, Për miratimin e shembjes së godinës të Teatrit Kombëtar, në pronësi të Bashkisë së Tiranës, bazuar në Akt Ekspertizën e hartuar nga Instituti i Ndërtimit Mbi vlerësimin e godinës së Teatrit Kombëtar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Pezullimi i zbatimit të këtyre akteve deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese</i></p>		<p><i>pasurisë nr. 1/241, me emërtimin Teatri Kombëtar në zonën kadastrale 8150, Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Shfuqizimi i vendimit nr. 50, datë 14.05.2020 të Këshillit Bashkiak Tiranë, Bashkia e Tiranës, Për miratimin e shembjes së godinës të Teatrit Kombëtar, në pronësi të Bashkisë së Tiranës, bazuar në Akt Ekspertizën e hartuar nga Instituti i Ndërtimit Mbi vlerësimin e godinës së Teatrit Kombëtar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Pezullimi i zbatimit të këtyre akteve deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, ju bëjmë me dije si më poshtë:</i></p>		
--	--	---	--	---	--	--

				<p>Sikurse jeni edhe në dijëni, çështja objekt i kësaj kërkesë është marrë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese në seanca plenare publike, të cilat janë zhvilluar në datat 03.06.2021, 15.06.2021 dhe 16.06.2021, dhe kanë qenë të aksesueshme nga gazetarët dhe persona të tjerë të interesuar. Në përfundim të këtij procesi, Gjykata ka marrë vendimin nr.29, datë 02/07/2021, me objektin e sipërcituar, në të cilin gjejnë pasqyrim të gjitha aktet e administruara nga Gjykata Kushtetuese, si ato të krijuara nga kjo e fundit ashtu edhe ato të krijuara nga institucionet e tjera publike. Lidhur me aktet e krijuara nga Gjykata Kushtetuese, siç është përmendur edhe me lart, ju bëjme me dije se përmbajtja e tyre është reflektuar edhe në përmbajtjen dhe arsyetimin e vendimit nr.29, datë 02/07/2021 të Gjykatës</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>Kushtetuese. Përsa i përket akteve të krijuara nga institucionet e tjera, ju informojmë se referencat e këtyre akteve janë të përmendura në mënyrë të detajuar në paragrafët 1 – 16 dhe në paragrafin 111, të këtij vendimi.</p> <p>Nëse jeni të interesuar për përmbajtjen e plotë të këtyre akteve, do t'ju sugjeronim të drejtoheshit pranë institucioneve respektive që i kanë prodhuar këto akte.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

6.	01.09.2021	<p>Kërkesë për informacion me objekt:</p> <p>1.Informacion të përgjithshëm mbi tarifën gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese përsa i përket ankimeve individuale, përfshirë tarifën e përgjithshme.</p> <p>2.Informacion specifik mbi tarifën gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese përsa i përket ankimeve individuale, përfshirë kohën dhe mënyrën e pagimit të tyre, vlerat e tarifave për thirrjen e dëshmitarëve etj.</p>	01.09.2021	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se për momentin Gjykata Kushtetuese nuk aplikon asnjë tarifë gjyqësore.	E Plotë	Nuk Ka
----	------------	--	------------	---	----------------	---------------

7.	29.09.2021	<p>Kërkesë për informacion mbi veprimet që ka ndërmarrë Gjykata Kushtetuese në lidhje me shqyrtimin e vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.55/2021, datë 09.06.2021 “Për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rënda të Kushtetutës”, ku më konkretisht kërkohet:</p> <p>1-Cili është relatori i kësaj çështje?</p> <p>2-A është shqyrtuar kërkesa në mbledhjen e gjyqtarëve?</p> <p>3-A është vendosur kalimi i çështjes në seancë plenare? Nëse po, cila ishte trupa gjyquese dhe si kanë votuar gjyqtarët?</p> <p>4-A ka respektuar Gjykata afatet procedurale në</p>	06.10.2021	<p>Në përgjigje të e-mail-it tuaj ju informojmë se çështja me kërkues Kuvendin e Republikës së Shqipërisë është regjistruar në Gjykatën Kushtetuese në datën 14.06.2021, e cila është data e depozitimit të kërkesës, dhe po kryhen të gjitha veprimet e parashikuara nga normat e përgjithshme të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000), për shqyrtimin paraprak të çështjes, si dhe ato të përcaktuara nga neni 61, pika 3 të po këtij ligji. Bazuar në nenin 62 të ligji nr. 8577/2000 shqyrtimi paraprak i kësaj çështje është në kompetencë të</p>	E kufizuar	Nuk Ka
----	------------	---	------------	--	------------	--------

		shqyrtimin e kësaj çështjeje?		<p>Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe ajo do të merret në shqyrtim nga Mbledhja e Gjyqtarëve në përputhje me procedurat ligjore të parashikuara.</p> <p>Po ashtu, ju sqarojmë se për periudhën 1 gusht 2021 deri në 10 shtator 2021, veprimtaria e gjykatës për shqyrtimin e të gjitha çështjeve ka qenë e pezulluar për shkak të lejes vjetore të gjyqtarëve, sipas përcaktimit të nenit 18, pika 1, shkronja "b", të ligji nr. 8577/2000.</p>		
--	--	-------------------------------	--	--	--	--

8.	13.10.2021	<p>Kërkesë për informacion me objekt vënie në dispozicion të informacionit në lidhje me fazën që ndodhet shqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.55/2021, datë 09.06.2021 “Për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rënda të Kushtetutës”, si dhe datës kur do të nis procesi gjyqësor pas mbarimit të shqyrtimit në Kolegj.</p>	15.10.2021	<p>Në Gjykatën Kushtetuese është në shqyrtim vendimi i Kuvendit të Shqipërisë nr.55/2021, datë 09.06.2021 “Për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rënda të Kushtetutës”.</p> <p>Ky vendim i është dërguar Gjykatës Kushtetuese me shkresën nr.1368 prot., datë 14.06.2021 të Kuvendit të Shqipërisë dhe është regjistruar në këtë Gjykatë në datën 14.06.2021, me numër të Regjistrimit Themeltar 6 (K) 2021.</p> <p>Gjykata e ka marrë në shqyrtim paraprak këtë çështje në përputhje me afatet procedurale të parashikuara në ligjin e saj organik dhe në Rregulloren e Brendshme,</p>	E kufizuar	Nuk ka
----	------------	---	------------	---	------------	--------

			<p>ndërkohë që veprimtaria e saj për shqyrtimin e të gjitha çështjeve ka qenë e pezulluar për periudhën 1 gusht 2021 deri në 10 shtator 2021, e cila përkon me lejen vjetore të gjyqtarëve, në bazë të nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.</p> <p>Në përfundim të shqyrtimit paraprak të kësaj çështjeje, bazuar në nenin 62 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata vendosi: “Kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike”, data e së cilës do të caktohet në përputhje me</p>		
--	--	--	---	--	--

				rregullat procedurale të gjyqimit kushtetues.		
--	--	--	--	---	--	--

9.	13.10.2021	<p>Kërkesë për infomacion me objekt procedurën e shqyrtimit të vendimit të Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, përfshirë mbërritjen e vendimit nga Kuvendi, hapat proceduralë për përfshirjen në axhendë për shqyrtimin e vendimit, afatet dhe kohën kur pritet të merret në shqyrtim në seancë paraprake, përbërjen e trupës gjyquese të seancës paraprake dhe çdo informacion tjetër të mundshëm rreth kësaj çështje”</p>	15.10.2021	<p>Në Gjykatën Kushtetuese është në shqyrtim vendimi i Kuvendit të Shqipërisë nr.55/2021, datë 09.06.2021 “Për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rënda të Kushtetutës”.</p> <p>Ky vendim i është dërguar Gjykatës Kushtetuese me shkresën nr.1368 prot., datë 14.06.2021 të Kuvendit të Shqipërisë dhe është regjistruar në këtë Gjykatë në datën 14.06.2021, me numër të Regjistrimit Themeltar 6 (K) 2021.</p> <p>Gjykata e ka marrë në shqyrtim paraprak këtë çështje në përputhje me afatet procedurale të parashikuara në ligjin e saj organik dhe në Rregulloren e Brendshme, ndërkohë që veprimtaria e saj për shqyrtimin e të</p>	E kufizuar	Nuk ka
----	------------	---	------------	---	------------	--------

			<p>gjitha çështjeve ka qenë e pezulluar për periudhën 1 gusht 2021 deri në 10 shtator 2021, e cila përkon me lejen vjetore të gjyqtarëve, në bazë të nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.</p> <p>Në përfundim të shqyrtimit paraprak të kësaj çështjeje, bazuar në nenin 62 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata vendosi: “Kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike”, data e së cilës do të caktohet në përputhje me rregullat procedurale të gjykimit kushtetues.</p>		
--	--	--	---	--	--

10.	12.11.2021	<p>Kërkesë për informacioni me objekt vënien në dispozicion të një kopje të autorizimit të personit të tretë Aleanca Për Mbrojtjen e Teatrit, për përfaqësimin e tij në çështjen me kërkues Presidenti i Republikës dhe objekt: “Shfuqizimi i ligjit nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar””, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare e etj..” (Vendim nr. 29 datë 02.07.2021).</p>	19.11.2021	<p>Në vijim të kërkesës suaj për informacion ardhur në datën 12/11/2021, drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë lidhur me çështjen me objekt: “Shfuqizimi i ligjit nr. 37/2018 Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Shfuqizimi i vendimit nr. 377, datë 08.05.2020 të Këshillit të Ministrave Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr. 1/241, me emërtimin Teatri Kombëtar në zonën</p>	E plotë	Nuk ka
-----	------------	--	------------	--	---------	--------

			<p><i>kadastrale 8150, Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.</i></p> <p><i>Shfuqizimi i vendimit nr. 50, datë 14.05.2020 të Këshillit Bashkiak Tiranë, Bashkia e Tiranës, Për miratimin e shembjes së godinës të Teatrit Kombëtar, në pronësi të Bashkisë së Tiranës, bazuar në Akt Ekspertizën e hartuar nga Instituti i Ndërtimit Mbi vlerësimin e godinës së Teatrit Kombëtar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Pezullimi i zbatimit të këtyre akteve deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese”, për të cilën ju kërkoni një kopje të autorizimit të</i></p>	
--	--	--	---	--

				<p>personit të tretë Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, ju informojmë se në bazë të nenit 3, pika 3, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit <i>“çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal...”</i>, dokumentet e kërkuara nga ana juaj mund t’ju vihen në dispozicion për t’u njohur me përmbajtjen e tyre brenda ambienteve të Gjykatës Kushtetuese.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

11.	12.11.2021	Kërkesë për informacion me objekt vënie në dispozicion në formë të shkruar, të njehësuar me origjinalin, kopje të procesverbaleve të të gjitha seancave gjyqësore që janë zhvilluar për çështjen e ligjit për teatrin.	18.11.2021	Në vijim të kërkesës suaj për informacion ardhur në datën 15/11/2021, drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me nr. 442 Prot., për çështjen me objekt: <i>“Shfuqizimi i ligjit nr. 37/2018 Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Shfuqizimi i vendimit nr. 377, datë 08.05.2020 të Këshillit të Ministrave Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr. 1/241, me</i>	E plotë	Nuk ka
-----	------------	--	------------	--	---------	--------

				<p><i>emërtimin Teatri Kombëtar në zonën kadastrale 8150, Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.</i></p> <p><i>Shfuqizimi i vendimit nr. 50, datë 14.05.2020 të Këshillit Bashkiak Tiranë, Bashkia e Tiranës, Për miratimin e shembjes së godinës të Teatrit Kombëtar, në pronësi të Bashkisë së Tiranës, bazuar në Akt Ekspertizën e hartuar nga Instituti i Ndërtimit Mbi vlerësimin e godinës së Teatrit Kombëtar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Pezullimi i zbatimit të këtyre akteve deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese”,</i></p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>për të cilën ju kërkonti t'ju vihet në dispozicion një kopje e njehsuar me orgjinalin e procesverbaleve të seancave gjyqësore të zhvilluara për këtë proces, ju informojmë se në bazë të nenit 3, pika 3, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "<i>çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit orgjinal...</i>", dokumentet e kërkuara nga ana juaj mund t'ju vihen në dispozicion për t'u njohur me përmbajtjen e tyre brenda ambienteve të Gjykatës.</p>		
--	--	--	--	--	--	--